



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENER GjISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ .06.2023

MBLEDHJA Nr. 35,
Datë 04.07.2023, ora 11:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Martë, datë 04.07.2023, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 35 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 27.06.2023
2. Mbi njohjen e licencës për furnizimin me energji elektrike, vazhduar nga Zyra e Rregullatorit për Energji Të Republikës Së Kosovës, për subjektin “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “Global Technical Mechanics” shpk për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
4. Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s 16, datë 23.01.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “DIEZELA” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Ljusa”, me kapacitet të instaluar 1980 kW”
5. Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarjes së Bordit të ERE-s në lidhje me aplikimin e shoqërisë “EU Green Energy” shpk për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku eolik i erës “Dropulli Wind”, me kapacitet të instaluar 20 MW
6. Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarjes së Bordit të ERE-s në lidhje me aplikimin e shoqërisë “Nova Solar System” shpk për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 50 MW
7. Çështje të tjera

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI